



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

USTAVNI SUD

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 tetor 2022

Nr. Ref.:RK 2063/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI58/22

Parashtrues

Avni Ndrecaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Pml. nr. 34/2022, të 21 shkurtit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Avni Ndrecaj nga Shtimja (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Xhavit Mahmuti, avokat në Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 34/2022] e 21 shkurtit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PAKR nr. 62/2021] e 15 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [PKR. nr. 176/19] e 29 dhjetorit 2020 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që për kërkesën e tij Gjykata të vendosë në seancë jopublike.
5. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon vendosjen e masës së përkohshme, me të cilën do të pezullohej ekzekutimi i Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 34/2022 të 21 shkurtit 2022.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet], 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 28 prill 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 10 maj 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR.KI58/22] caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 13 maj 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
10. Më 19 maj 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës.

11. Më 31 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme, me të cilën do të pezullohej ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 34/2022 të 21 shkurtit 2022.
12. Më 8 shtator 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se Prokuroria Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Themelore), më 2 dhjetor 2019, ngriti Aktakuzë [PP. I. nr. 115/19] kundër parashtruesit të kërkesës dhe vëllait të tij N.N., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale "Vrasje në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 172 lidhur me nenin 31 dhe nenin 12 par. 3" të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK).
14. Më 29 dhjetor 2020, Gjykata Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 176/19], shpalli parashtruesin e kërkesës dhe vëllain e tij N.N. fajtor për kryerjen e veprës penale vrasje në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 31 dhe nenin 12 paragrafi 3 dhe 4 të KPRK-së, duke ua caktuar dënimin me burgim, dhe atë parashtruesit kërkesës dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe vëllait të tij N.N. dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj.
15. Gjykata Themelore arsyetoi se ndaj parashtruesit të kërkesës dhe vëllait të tij ka ekzistuar një rrezik potencial për pasurinë dhe integritetin trupor (jetën), por se në situatën e dhënë, me veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe vëllait të tij N.N. është tejkaluar qartazi mbrojtja e nevojshme, pasi që nga momenti i sulmit ndaj të akuzuarve dhe pasurisë së tyre kishte pushuar rreziku për arsye se tani i ndjeri ishte kapur-zënë nga të akuzuarit, u çarmatos dhe rreziku ishte tejkaluar tashmë, sulmi kishte pushuar me vetë faktin se nga tani i ndjeri ishte larguar pistoleta dhe ai lehtë mund të vihej në kontroll.
16. Në vazhdim të arsyetimit, Gjykata Themelore analizoi dispozitën e nenit 31 të KPRK-së, duke theksuar se, *"Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thellësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale"* dhe ka konstatuar se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore dhe ekzistojnë elementet objektive dhe subjektive të bashkëkryerjes nga neni 31 i KPRK-së, duke vlerësuar se të dy të akuzuarit A. N. dhe N. N., të vetëdijshtë, së bashku i kanë ndërmarrë si në pjesën e dispozitivit të aktakuzës, ku pasi që tani i ndjeri së bashku me A. T. ishin larguar nga shtëpia e të pandehurit N.N., ku fillimisht edhe ishin përleshur aty, më pas i pandehuri N. N. ka kërkuar ndihmë nga vëllai i tij, i pandehuri A.N, e të cilët me qëllim të mbrojtjes së pasurisë së tyre, vrapojnë diku në distancë rreth 300 m, gjersa tani i ndjeri së bashku me A. T. kanë shtënë me armë në drejtim të akuzuarve, me ç'rast arrijnë te i ndjeri F.G., fillon përleshja, ku në duar i ndjeri kishte një armë dhe një thikë, ku fillimisht i pandehuri A.N.me një letvë e godet në pjesë të trupit duke e rrëzuar në tokë, e më pas involvohet edhe i pandehuri N.N i cili fillimisht ia largon armën nga dora e më pas me thikën të cilën arrin t'ia merr nga dora të ndjerit, e godet disa herë në regjionin e djathtë të qafës, me ç'rast si rezultat i gjakderdhjes së jashtme dhe si pasojë e plagës tejshkuese në regjionin e djathtë të qafës i njëjti ndërron jetë dhe me këtë rast secili prej të

akuzuarve me këto veprimet e tyre së bashku kanë marrë pjesë në kryerjen e kësaj vepre penale”.

17. Më 13 janar 2021, kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 176/19] të Gjykatës Themelore të 29 dhjetorit 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit për sanksionin penal. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës i propozoi Gjykatës së Apelit që të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke e liruar nga akuza ose çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.
18. Në një datë të pacaktuar, ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë kanë ushtruar edhe familjet e të dëmtuarve, duke kërkuar që aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet në atë mënyrë që parashtruesit të kërkesës dhe N.N. t'u shqiptohen dënimet më të gjata me burgim.
19. Më 15 qershor 2021, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [KŽ1. nr. 62/21], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, si dhe ankesën e familjes së të dëmtuarve dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [PKR. nr. 176/19] e Gjykatës Themelore të 29 dhjetorit 2020, për të cilin konstatoi se gjendja faktike është vërtetuar drejt, se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit material dhe se dënimi i shqiptuar me burgim është matur siç duhet, sepse i përgjigjet peshës së veprës penale e cila është kryer pa mëdyshje.
20. Në arsyetimin e Aktvendimit të lartpërmendur, Gjykata e Apelit vlerësoi se Gjykata Themelore ka zbatuar në mënyrë të drejtë nenin 172 në lidhje me nenin 31 dhe nenin 12 paragrafi 3 dhe 4 të KPRK-së, duke theksuar se, *“Gjykata e Apelit konsideron se në një situatë të tillë nuk ka mundur të kërkohej nga të pandehurit të cilët kanë qenë të sulmuar nga ana e të dëmtuarit që në mënyrë të ftohtë dhe të matur të gjykojnë për situatën dhe ta përshtatin mbrojtjen në atë mënyrë që ajo të përputhet plotësisht me intensitetin e sulmit. Edhe pse të akuzuarit e kishin hequr revolen nga duart e të dëmtuarit, ai ende kishte në posedim një mjet të rrezikshëm – thikën me sulme tashmë të kryera ndaj tyre duke qëlluar me armë në drejtim të tyre gjatë arratisjes nga shtëpia e N.N. ku ka hyrë ilegalisht, dhe atë në momentin kur i pandehuri N.N. thërret në ndihmë A.N. Duke pasur parasysh faktin se në momentin kur të akuzuarit u gjendën, siç thonë në gjuhën popullore, ballë për ballë me të dëmtuarin, kur të dyja palët kishin në posedim faktik vetëm një thikë, pasi arma, pasi iu hoq të dëmtuarit nga duart nga të akuzuarit u hodh në bar në kushtet e padukshmërisë gjatë natës, është krijuar një realitet që është vlerësuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, i cili vlerësim mbështetet edhe nga Gjykata e Apelit, që është se të akuzuarit kanë mundur ta mposhtin të dëmtuarin edhe në një mënyrë tjetër sepse ata ishin dy ndërsa i dëmtuari ishte i vetëm. Ta mposhtin në një mënyrë tjetër pa i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse në enët e gjakut të qafës. Mirëpo, në një realitet të tillë kur ekziston një ngarkesë e fortë të emocioneve, veçanërisht emocioneve të frikës dhe zemërimit, është e vështirë të veprohet në mënyrë racionale. Për këto arsye, Gjykata e Apelit nuk e pranon qëndrimin e mbrojtësve të të akuzuarve se në veprimet e të akuzuarve nuk ka tejkalim të mbrojtjes së nevojshme”.*
21. Më 29 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit [KŽ1. nr. 62/21] të Gjykatës së Apelit të 15 qershorit 2021, paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve të dispozitave të kodit të procedurës penale, shkeljeve të dispozitave të kodit penal dhe për shkak të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke pretenduar se

gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe se nuk janë matur qartë shkalla e mbrojtjes së nevojshme të zbatuar në rastin konkret dhe shkalla e përgjegjësisë së parashtruesit të kërkesës në veprën penale të kryer, se gjatë matjes së dënimit të shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës nuk janë marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe se cilësia e tekstit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nuk ka qenë e kënaqshme.

22. Më 21 shkurt 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 34/2022] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke vërtetuar në tërësi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.
23. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe se nuk janë matur qartë shkalla e mbrojtjes së nevojshme të zbatuar në rastin konkret dhe shkalla e përgjegjësisë së parashtruesit të kërkesës në veprën penale të kryer, Gjykata Supreme arsyetoi se, *“Në aktgjykim është dhënë arsyetim përkitazi me faktin vendimtar-tejkalimin e mbrojtjes së nevojshme, se sulmi ka filluar pasi që tani i ndjeri e kishte pamundur sulmin ndaj të dënuarve pasi që në ndërkohë nga duart e tij ishin hequr mjetet për sulm (thika dhe arma), dhe me këtë ishte minimizuar për të mos thënë ishte mënjeluar rreziku i mëtejme i sulmit, andaj në këto rrethana kur mundësia e sulmit ishte minimale, çfarëdo natyre e sulmit të mëtejme paraqet tejkalim të mbrojtjes së nevojshme. Në këtë kontekst dinamika e zhvillimit të ngjarjes, përkatësisht koha e zhvillimit të ngjarjes, sipas pikëpamjes së kësaj gjykate është faktor i natyrës dytësore, pasi që faktorët kyç në ngjarje janë: fillimi i sulmit deri te përfundimi i tij, privimi i mundësisë së sulmit dhe mjetet e përdorura. Nga kjo rrjedh se sulmi ishte zhvilluar brenda shtëpisë së tani të dënuarit N. N., pastaj ishte vazhduar me ikjen e tani të ndjerit dhe ndjekjen nga ana e të dënuarve, përkatësisht zënien e tij pas një distance prej 300 metra nga shtëpia ku ishte filluar ngjarja, dhe më rëndësishmja në këtë zingjir të ngjarjes është fakt i zënies së të ndjerit e cila erdhi si pasojë e lëndimit të tij dhe pastaj largimi nga duart e tij të mjeteve për sulm, dhe pas kësaj goditja e tani të ndjerit, paraqet tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, për faktin se sulmi tani më kishte kaluar dhe mundësia e vazhdimit të sulmit nga ana e tani të ndjerit ishte minimale”*.
24. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se cilësia e tekstit të Gjykatës së Apelit nuk është e kënaqshme, Gjykata Supreme arsyetoi se, *“duke pasur parasysh faktin se aktgjykimi burimor është shkruar në gjuhën serbe dhe i njëjti është përkthyer në gjuhën shqipe, gjatë përkthimit të tij mund të ketë ndodhur eventalisht ndonjë gabim i papërfillshëm të natyrës gjyqësore. Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo në asnjë rrethanë nuk e bënë të paqartë dhe të pakuptueshëm substratin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, përkatësisht në të dy versionet e aktgjykimit (versioni në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe) është dhënë arsyetim i detajuar dhe nuk janë evidentuar mos përputhje në aktgjykimet e lartcekura”*.

Pretendimet e parashtruesit

25. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
26. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës ka disa pretendime të cilat i arsyeton në këtë mënyrë:

- a) Lidhur me barrën e provës dhe barazinë e palëve, [...] Gjykata Themelore shkeli të drejtën e garantuar nga neni 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 par. 2 të Konventës, kur pa një ekspertizë neuropsikiatrike me rezultat negativ (të përjashtimit të tronditjes së fortë psikike dhe frikës) erdhi në përfundimin të cilin e përqafuan edhe dy instancat tjera më të larta gjyqësore se të pandehurit veprën penale sipas aktakuzës e kanë kryer me dashje. Mbrojtja e parashtruesit gjatë procedurës nuk ka pa të nevojshme që të kërkojë caktimin e ekspertizës së tillë, pasi që në aktakuzë prokurori i shtetit kryerjen e kësaj veprë penale e ka cilësuar nga tronditja e fortë psikike dhe frika. Pavarësisht qëndrimeve të Prokurorisë dhe të mbrojtjes, Gjykata Themelore duke u bazuar në peshën e veprës penale dhe specifikat tjera të rastit është dashur që me vetiniciativë, në bazë të parimit të subsidiaritetit dhe parimit të barazisë së palëve të urdhëroj ekspertizën psikiatrike për të pandehurit, e kjo edhe nga fakti se prezumimi i pafajësisë të pandehurit nuk e ngarkon që ta provojë pafajësinë e tij. Pafajësinë e tij i pandehuri mund ta provojë me ofrimin e provës në favor të tij, për të cilën prokuroria dhe gjykata nuk kanë njohuri”.
- b) Lidhur me shkeljen e të drejtës për një gjykim të drejtë, [...] parashtruesi në ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë drejtuar Gjykatës së apelit ka paraqitur pretendimin se gjykata e shkallës së parë kur vendosi ta shpallë fajtor dhe ta dënojë kërkuesin nuk vlerësoi në mënyrë të drejtë kontributin e secilit të bashkakuzuar veq e veq në shkaktimin e pasojës në vështirim të nenit 31, nuk vlerësoi lidhjen kauzale në mes veprimeve të kërkuesit dhe shkaktimit të pasojës së ndaluar në vështirim të nenit 20 të KP, nuk përfshiu dhe nuk i shqyrtoi edhe veprimet e akterëve që sipas aktakuzës ishin përfshirë në anën e sulmit në krah të F. G. dhe A. T., ndërsa me rastin e gjykimit të proporcionalitetit të tejkallimit të mbrojtjes së nevojshme po ashtu nuk i vlerësoi në mënyrë adekuate rrethanat në lidhje me rrezikun që paraqit sulmi për kërkuesin dhe rrethanat mbi nevojën dhe domosdoshmërinë për mbrojtjen nga ky sulm në mënyrën siç kishte vepruar në natën kritike”. Krahas këtyre pretendimeve lidhur me këtë shkelje të të drejtave, parashtruesi i kërkesës gjithashtu ngre pretendimet për, “mospërfshirjen në aktgjykim edhe të akterëve tjerë në anën e sulmit, lidhjen kauzale në mes të veprimit të kërkuesit me pasojnë e shkaktuar, momentin e pushimit të sulmit dhe “kohën e kaluar apo veprimin e mëvonshëm” pas pushimit të sulmit”.
27. Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 33 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se rrethanat lehtësuese nuk janë zbatuar drejtë në rastin e tij dhe se, për rrjedhojë, ka pasur shkelje të parimit të proporcionalitetit në çështjet penale. Këtë pjesë të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, e arsyeton si në vijim:

[...] Doktrina bashkëkohore dhe praktikat e avancuara gjyqësore gjykimin e proporcionalitetit të mbrojtjes së nevojshme e bëjnë sipas kriterit *ex ante* e kjo do të thotë vlerësimi i të gjitha rrethanave që i kanë paraprirë ngjarjes e kjo para së gjithash duke i balancuar në rend të parë të mirat e rrezikuara dhe të mirat e sakrifikuara juridike që në këtë rast ekziston homogjenitet në mes tyre (gjykimi statik), mjetet e përdorura nga ana e sulmuesit dhe ato që i përdori i sulmuari, koha, intensiteti, gjendja psikike, ku këtu përveç të të pandehurit tronditja e fortë psikike ka qenë prezente edhe tek sulmuesi F.G. e kjo ka ndikuar që sulmi ndaj të pandehurve të jetë edhe më i ashpër, forca fizike e sulmuesit dhe e të sulmuarit (gjykimi dinamik) e jo duke marrë parasysh vetëm episodin e fundit të ngjarjes ose vetëm pasojën e shkaktuar.

Gjykata Supreme, gjykata themelore dhe ajo e apelit në arsyetimet e veta nuk i kanë analizuar as kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Ato përveç citimit rutinor të frazës “nuk

është e bazuar” kanë dështuar ti rrëzojnë argumentet e mbrojtjes se sulmi ishte i atëqsëshëm, i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Dhe pa rrëzimin e këtyre pretendimeve sipas kriterit se asnjë gjyqtarë nuk do të kishte mund të vendosë ndryshe nuk kanë mundur të arrijnë në përfundimin se parashtruesi ka kaluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme sipas standardit përtej dyshimit të arsyetuar mirë, e që në këtë rast Gjykata Themelore në arsyetim të aktgjyqimit ka dështuar në arritjen e këtij standardi dhe Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë qëndruar indiferente”.

28. Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të cilësisë së përkthimit të Aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson se:

[...] Gjykata e Apelit, në respektim të së drejtës së përdorimit të gjuhës të cilën e flet pala, parashtruesit ia dërgon aktgjykimin në gjuhën shqipe pasi që aktgjykimi burimor është nxjerrë në gjuhën serbe. Mirëpo ky aktgjykim edhe pse palës iu është dërguar i përkthyer, në respektim të kësaj të drejte, megjithatë me përjashtim të dy faqeve të para (faqja 1 dhe 2) të tjerat për shkak të përkthimit konsiderueshëm të dobët e jo kualitativ, për parashtruesin e kërkesës ky aktgjykim është i pakuptueshëm dhe si i tillë cenon të drejtën e tij për marrjen e aktgjyqimit me përkthim kualitativ dhe të kuptueshëm për të. [...] Për respektimin e garancisë së të drejtës për përkthim nuk është i mjaftueshëm vetëm fakti i dorëzimit të parashtrësive në gjuhën që e flet pala dhe fakti që përkthimi për nga përmbajtja të mos jetë ndryshe me origjinalin, por edhe fakti që përkthimi të jetë kualitativ, i përkthyer nga përkthyesi profesional dhe i autorizuar në mënyrë që pala lehtësisht të kuptoj në mënyrë që ajo të jetë në gjendje të paraqesë vërejtjet e veta mbrojtjes në lidhje me mjetin juridik“.

Lidhur me këtë kërkesë, parashtruesi kërkon nga Gjykata caktimin e ekspertit gjuhësor me qëllim të përcaktimit të cilësisë së versionit të Aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit në gjuhën shqipe, i cili duhet të konstatojë nëse përkthimi i aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 62/21 në gjuhën shqipe nga gjuha serbe (në këtë rast burimor) i plotëson standardet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat nga neni 30 i Kushtetutës, por nuk i arsyeton dhe nuk i shpjegon ato.
30. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të konstatojë shkeljen e neneve të përmendura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, dhe “të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin [PML. nr. 34/2022] e 21 shkurtit 2022, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; aktgjykimin [PAKR. nr. 62/2021] të 15 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe aktgjykimin [PKR. nr. 176/2019] të 29 dhjetorit 2020 të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Ferizaj ose të kthejë çështjen në rigjykim në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Ferizaj“.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që gjatë procedurës së vendimmarrjes të vendosë në një seancë jopublike për shkak të “sëmundjes psikike nga e cila vuan parashtruesi i kërkesës dhe që është një nga arsyet e konstatimit të ekspertizës neuropsikiatrike të aftësisë së zvogëluar mendore“.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;*
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;*
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;*
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;*
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.*

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatare, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*
- 6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.*
- 7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.*

Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

- 1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të*

veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.

2. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.

3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.

4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.

[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

[...]

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

[...]

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NR. 06/L-074

[...]

Neni 12

Mbrojtja e nevojshme

1. *Vepra e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale.*
2. *Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.*
3. *Disproporcioni ndërmjet sulmit dhe zbrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.*
4. *Kryesi i cili i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme mund të dënohet më lehtë. Nëse kryesi tejkalon kufijtë për shkak të tronditjes së fortë apo frikës së shkaktuar nga sulmi, ai mund të lirohet nga dënimi.*

[...]

Neni 31
Bashkëkryerja

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

[...]

Neni 172
Vrasja

Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata së pari i referohet

neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ”.

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, gjegjësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 34/2021] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 21 shkurtit 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
36. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
37. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Me saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
38. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e

saktë t'iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*”.

39. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
40. Gjykata rikujton se esenca e rastit ndërlidhet me faktin se Gjykata Themelore e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale në bashkëkryerje “*Vrasje në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 172 lidhur me nenin 31 dhe nenin 12 paragrafi 3*” të KPRK-së dhe i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e mbështeti në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar në tërësi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit.
41. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston para Gjykatës konstatimin e gjykatave të rregullta, duke pretenduar, në thelb, shkelje të neneve 30, 31 dhe 33 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të KEDNJ-së, sepse, sipas tij, gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, duke anashkaluar provat dhe duke mos marrë parasysh nenet e tjera relevante.
42. Parashtruesi i kërkesës i ndau pretendimet e tij në këtë mënyrë:
 - (i) Nenin 30 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës vetëm e përmend, por nuk shpjegon se si ka ndodhur shkelja e këtij neni.
 - (ii) Nenin 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës e arsyeton duke theksuar se:
 - a) Gjykata Themelore, pa ekspertizë neuropsikiatrike, doli në përfundim se vepra penale për të cilën është akuzuar, është kryer me dashje, dhe se këto konkluzione janë pranuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme; dhe
 - b) Gjendja faktike në aktgjykimet e gjykatave të rregullta është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar gabimisht, sepse nuk është vlerësuar “*...në mënyrë të drejtë kontributi i secilit të bashkakuzuar veq e veq në shkaktimin e pasojës*”, si dhe që aktgjykimet nuk kanë përfshirë edhe akterët e tjerë në rastin konkret dhe “*...lidhjen kauzale në mes të veprimit të kërkuesit me pasojën e shkaktuar, momentin e pushimit të sulmit dhe “kohën e kaluar apo veprimin e mëvonshëm” pas pushimit të sulmit*”.

- (iii) Nenin 33 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës e arsyeton duke theksuar se rrethanat lehtësuese nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë dhe për rrjedhojë është shkelur parimi i proporcionalitetit.
 - (iv) Nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës e arsyeton duke theksuar se cilësia e përkthimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nuk është e cilësisë së kënaqshme.
43. Gjykata në vazhdim do të merret me shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve të lartcekura të parashtruesit të kërkesës veç e veç.
- (i) *Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës***
44. Sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 30 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës të vendosur gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime *“të pambështetura ose të paarsyetuara”* kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (Vendim)*, kërkesa nr. 4241/03, të 31 majit 2005; shih, gjithashtu, *Baillard kundër Francës (Vendim)*, kërkesa nr. 6032/04, të 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat to t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 42).
45. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës thjesht ka përmendur shkeljet e nenit 30 të Kushtetutës, por parashtruesi në kërkesën e tij nuk jep më tej ndonjë arsyetim më të detajuar se si ka ndodhur shkelja e këtij neni.
46. Sa i përket këtij pretendimi, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm e përmend nenin përkatës, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtij neni përkatës të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi në nenet e Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81; KI166/20, cituar më lart, paragrafi 52; KI04/21, cituar më lart, paragrafët 38-39).

47. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 30 të Kushtetutës, kërkesa duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar, pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyetuara” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato janë shkelur. Rrjedhimisht, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me a) ekspertizën psikiatrike

48. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës me arsyetimin se gjatë procedurës para gjykatave të rregullta, Gjykata Themelore së pari duhej të kryente ekspertizën neuropsikiatrike dhe se pas kësaj, është detyrë e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të korrigjojnë këtë mangësi edhe pa insistimin e parashtruesit të kërkesës.
49. Lidhur me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson sa vijon: *“Mbrotjtja e parashtruesit gjatë procedurës nuk e pa të nevojshme që të kërkojë caktimin e ekspertizës së tillë, pasi që në aktakuzë prokurori i shtetit kryerjen e kësaj veprë penale e ka cilësuar nga tronditja e fortë psikike dhe frika. Pavarësisht qëndrimeve të Prokurorisë dhe të mbrotjtjes, Gjykata Themelore duke u bazuar në peshën e veprës penale dhe specifikat tjera të rastit është dashur që me vetiniciativë, në bazë të parimit të subsidiaritetit dhe parimit të barazisë së palëve të urdhëroj ekspertizën psikiatrike për të pandehurit, e kjo edhe nga fakti se prezumimi i pafajësisë të pandehurin nuk e ngarkon që ta provojë pafajësinë [...]”*.
50. Sa i përket këtij pretendimi, Gjykata, në bazë të shkresave të lëndës, konstatoi se ekspertiza psikiatrike është kryer gjatë procedurës para Gjykatës Themelore, gjithashtu, në bazë të deklaratës së parashtruesit dhe nga shkresat e lëndës rezulton se kjo çështje nuk është ngritur nga parashtruesi i kërkesës përgjatë procedurës para Gjykatës së Apelit. Për më tepër, Gjykata vëren se sipas shkresave të lëndës rezulton se kjo çështje nuk është ngritur as para Gjykatës Supreme përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial.
51. Gjykata fillimisht thekson se, përderisa në kontekstin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rregulli për shterimin e mjeteve juridike duhet të aplikohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa ndonjë formalizëm të tepruar, ky rregull zakonisht kërkon që ankesat e pretendimet që synohen të ngrihen më vonë në proces gjyqësor, duhet të jenë ngritur edhe para gjykatave të rregullta, të paktën në substancë dhe në respektim të kushteve formale dhe afateve të përcaktuara përmes ligjit të aplikueshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesat 2478/15 dhe 1787/15, të 16 korrikut 2015, paragrafi 89 dhe referencat e përfshira aty).
52. Edhe më konkretisht, GJEDNJ mban qëndrimin se, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë

gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty).

53. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dyja kuptimet (shih, po ashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI71/18, parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafi 57).
54. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës, rezultojnë se këto pretendime specifike të parashtruesit të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, kjo e fundit konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ua ka dhënë mundësinë gjykatave të rregullta, përkatësisht Gjykatës Supreme, të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngre drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-36).
55. Si rrjedhojë, për sa i përket këtij pretendimi, respektivisht pretendimit për ekspertizën neuropsikiatrike, Gjykata konstaton se i njëjti duhet të refuzohet si pretendim i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me b) vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta

56. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston arsyetimet e gjykatave të rregullta, sepse ato nuk përputhen me faktet vendimtare dhe zbatimin e ligjit në rastin e tyre. Parashtruesi i kërkesës parashtron të njëjtat pretendime, që ai kishte parashtruar edhe para gjykatave të rregullta dhe që kanë të bëjnë kryesisht me shkeljet e ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, ndërsa konkretisht ankohet për mënyrën e cilësimit të veprës penale të kryer, provat që janë administruar në rastin e tij dhe mënyrën se si është konstatuar shkalla e fajësisë së tij.
57. Lidhur me këtë, Gjykata, fillimisht, rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë ose për të vendosur nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur prova të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës (shih, në këtë drejtim, rastin e Gjykatës KI56/21, parashtrues *Emrush Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 tetorit 2021, paragrafi 38). Në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, kjo ndërlihet

me konstatimin e gjykatave të rregullta përkitazi me dënimin e tyre për veprën penale të vrasjes në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme në bashkëkryerje dhe për rrjedhojë bie në kategorinë e pretendimeve “*të shkallës së katërt*”, sepse ngërthen çështje që ndërlidhen me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, përkatësisht me “*ligjshmërinë*” dhe jo me “*kushtetutshmërinë*”.

58. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, gjë që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në esencë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së: *Ballıtaş Bingöllü kundër Turqisë*, nr. 76730/12, të 22 qershorit 2021, paragrafi 75; *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, cituar më lart, paragrafi 28; dhe *Perlala kundër Greqisë*, nr. 17721/04, Aktgjykim i 22 shkurtit 2007, paragrafi 25).
59. Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës KI75/17, parashtrues: X, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 59).
60. Për më tepër, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, për të përcaktuar nëse procedura ka qenë e drejtë në tërësinë e saj, duhet gjithashtu të merret parasysh fakti nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në veçanti, duhet të ekzaminohet nëse parashtruesve të kërkesës iu është ofruar mundësia për të sfiduar vërtetësinë e provave dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre. Për më tepër, cilësia e provave duhet të merret në konsideratë, dhe gjithashtu rrethanat në të cilat janë marrë ato, dhe nëse këto rrethana hedhin dyshime në bazueshmërinë ose saktësinë e tyre. Megjithatë nuk është e thënë të ketë ndonjë problem rregullsie në qoftë se provat e mbledhura nuk vërtetohen edhe përmes provave të tjera, duhet shënuar se kur ato janë shumë të qëndrueshme dhe nuk vihen fare në dyshim, nevoja për prova të tjera në mbështetje të tyre bëhet më e vogël (shih rastin e GJEDNJ-së *Bykov kundër Rusisë*, Aktgjykim i 10 prillit 2009, paragrafi 87).
61. Në lidhje me pretendimin e lartcekur të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta ofruan arsyetimin përkatës për shpalljen fajtor për veprën penale të vrasjes në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme në bashkëkryerje, siç parashihet në nenin 172 në lidhje me nenin 31 dhe nenin 12 paragrafi 3 dhe 4 të KPRK-së. Gjykatat e rregullta ishin bazuar në faktet dhe provat përkatëse, konkretisht në (i) ekspertizën e ekspertit/mjekut të fushës së psikiatrisë; (ii) deklaratat e dëshmitarit i cili dëshmoi në lidhje me veprën penale të kryer; (iii) raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës, të 23 gushtit 2018; (iv) deklaratat e parashtruesit të kërkesës dhe vëllait të tij ku kanë përshkruar rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së veprave penale. Këto deklarata të parashtruesit të kërkesës dhe gjetjet e ekspertit, sipas Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme janë në përputhje të plotë me raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe fotodokumentacionin nga vendi i ngjarjes.
62. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, ndër të tjera, në Aktgjykimin e saj [PML. nr. 34/2022], arsyetoi në fund se:

“Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet e theksuara përkitazi me shkeljen e ligjit penal, përkatësisht faktin se ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim i rëndë dhe joproportional, pasi që disa rrethana lehtësuese nuk janë marrë parasysh me rastin e matjes së dënimit, konstatoj se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar brenda kornizave të minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar për veprën penale të shpallur fajtor, dhe për më tepër, ne faqen 21 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë thekuar në tërësi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par. 5 të KPPK-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkaluar kompetencat ligjore e cila në rastin konkret nuk ka ndodhur. Përndryshe, duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore, dhe arsyet e dhëna përkitazi me vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale.

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penale, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, megjithatë, bazuar në përmbajtjen e saj janë paraqitur pretendimet përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, bazuar në dispozitën e nenit 432 par. 2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj pjesa e kërkesës e paraqitur për këtë bazë është refuzuar si e pabazuar.

[...]”.

63. Gjykata vëren se Gjykata Supreme refuzoi, si të pabazuara, pretendimet e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se (i) dispozitivi i Aktgjykimit përmban një përshkrim të hollësishëm dhe thekson plotësisht të gjitha elementet qenësore që përbëjnë figurën e veprës penale vrasje në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme në bashkëkryerje, kjo sepse sipas nenit 172 në lidhje me nenin 31 të KPPK-së, konsiderohet se kur dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për këtë vepër penale; (ii) rrethanat, mënyra dhe veprimet e të dënuarve janë arsyetuar mjaftueshëm në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore; dhe (iii) aspekti i tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme është adresuar nga gjykata e shkallës së parë në faqen 20 të Aktgjykimit të saj.
64. Gjykata konsideron se këto interpretime të dispozitave përkatëse ligjore, të bëra nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta, nuk kanë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme në rastin e parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës përgjatë procedurës kishte mundësinë për t'i kundërshtuar provat, për të cilat gjykatat e rregullta kishin dhënë përgjigje përkatëse.
65. Gjykata rrjedhimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka pasur përfitimet e procedurës kontradiktore; ai ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës të

paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; e ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës; arsyet faktike dhe juridike për vendimet e kundërshtuara janë paraqitur në detaje, prandaj, procedura, shikuar në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim i 7 korrikut 2019, paragrafi 42; si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).

66. Prandaj, Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme, i cili i referohet kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55; dhe shih në këtë drejtim, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
67. Prandaj, bazuar në sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij se si vendimet e gjykatave të rregullta, në veçanti Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me faktet vendimtare dhe provat janë qartazi të pabazuara mbi baza kushtetuese, si pretendime të “*shkallës së katërt*”, siç është përcaktuar në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

(iii) Lidhur me pretendimet për shkeljen e të drejtave të të akuzuarit, të garantuara me nenin 33 të Kushtetutës

68. Në kuptim të shkeljes së nenit 33 të Kushtetutës, gjegjësisht shkeljes së të drejtave të të akuzuarit, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës pretendon se, “*Gjykata Supreme, gjykata themelore dhe ajo e apelit në arsyetimet e veta nuk i kanë analizuar as kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Ato përveç citimit rutinor të frazës “nuk është e bazuar” kanë dështuar ti rrëzojnë argumentet e mbrojtjes se sulmi ishte i atëqsëshëm, i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Dhe pa rrëzimin e këtyre pretendimeve sipas kriterit se asnjë gjyqtarë nuk do të kishte mund të vendosë ndryshe nuk kanë mundur të arrijnë në përfundimin se parashtruesi ka kaluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme sipas standardit përtej dyshimit të arsyetuar mirë, e që në këtë rast Gjykata Themelore në arsyetim të aktgjykimit ka dështuar në arritjen e këtij standardi dhe Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë qëndruar indiferente*”.
69. Edhe pse parashtruesi i kërkesës e paraqet këtë pretendim si shkelje të nenit 33 të Kushtetutës, Gjykata vëren se të drejtat të cilave u referohet parashtruesi i kërkesës janë në thelb të drejtat e mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës.
70. Bazuar në sa më sipër, Gjykata thekson se nuk do të merret në mënyrë specifike me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, për arsye se Gjykata për çështjen e procedurës provuese, gjendjes faktike dhe çështjen e caktimit të dënimit, e trajtoi këtë pjesë të pretendimit në arsyetimin e pretendimit për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

(iv) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së në lidhje me cilësinë e përkthimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe kërkesën për caktimin e ekspertit gjuhësor

71. Sa i përket këtij pretendimi konkret të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se i njëjti pretendim është ngritur nga parashtruesi i kërkesës edhe para Gjykatës Supreme. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme u përgjigj: “[...] pretendimet e paraqitura në kërkesë për paqartësinë gjuhësore dhe gramatikore nga ana e kësaj gjykate nuk janë të bazuara. Megjithatë duke pasur parasysh faktin se aktgjykimi burimor është shkruar në gjuhën serbe dhe i njëjti është përkthyer në gjuhën shqipe, gjatë përkthimit të tij mund të ketë ndodhur eventualisht ndonjë gabim i papërfillshëm të natyrës gjyqësore. Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo në asnjë rrethanë nuk e bën të paqartë dhe të pakuptueshëm substratin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, përkundrazi në të dy versionet e aktgjykimit (versioni i gjuhën serbe dhe shqipe) është dhënë arsyetim i detajuar dhe nuk janë evidentuar mos përputhje me aktgjykimet e lartcekura”.
72. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës për këtë çështje kërkon nga Gjykata caktimin e një eksperti gjuhësor.
73. Duke u bazuar në sa më sipër, Gjykata thekson se ajo nuk do të merret në mënyrë specifike me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, për arsye se Gjykata Supreme i ka dhënë parashtruesit të kërkesës arsyetime të mjaftueshme për këtë çështje.

Kërkesa për mosmbajtje të seancës publike

74. Gjykata, krahas pretendimeve të tjera në kërkesë, vërejtë se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon mosmbajtjen e seancës publike, duke theksuar se publikimi i detajeve të sëmundjes së parashtruesit të kërkesës, *do të shkaktonte pasoja të pariparueshme në jetën e tij personale dhe private e cila edhe ashtu konsiderueshëm iu është rënduar pas ndodhjes së këtij rasti penal.*
75. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.*
- 2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës”.*
76. Në bazë të paragrafit 1 të nenit 20 të Ligjit dhe vetë kërkesës së parashtruesit, Gjykata do të vendosë për këtë rast në seancë jopublike.

Kërkesa për vendosje të masës së përkohshme

77. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme, me të cilën do të pezullohej ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 34/2022 të 21 shkurtit 2022.

78. Mirëpo, Gjykata tashmë konkludoi se kërkesa e parashtruesit duhet të shpallet e papranueshme në baza kushtetuese.
79. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në përputhje me rregullin 57 (1) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet pasi që e njëjta nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit duke qenë se kërkesa është shpallur e papranueshme.

Përfundim

80. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 30 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme në tërësinë e tyre, si qartazi të pabazuara, sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) pretendime *“të pambështetura ose të paarsyetuara”* dhe se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës për sa i përket ekspertizës psikiatrike kualifikohen si pretendime të papranueshme në baza procedurale për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në kuptimin substancial, ndërsa sa i përket pretendimeve të tjera lidhur me shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në tërësi si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafët (1) (b) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (b) dhe (2), 57 (1) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 8 shtator 2022, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË APROVOJË kërkesën për mosmbajtje të seancës publike;
- III. TA REFUZOJË kërkesën për vendosje të masës së përkohshme;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- V. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani